

VENDIM
Nr.41, datë 31.5.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DISHNICA ENERGIJ” SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13, pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, bordi i komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.5.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Dishnica Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

- Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikën 4.1.5 germat “a” dhe “c” të nenit 9, përkatësisht: Miratimi i OST-së dhe OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të tregutit dhe leja mjedisore nga organet përkatëse është në pritje për t’u plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Dishnica Energji” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec-Dishnicë”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta